



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.33/2018

Prishtinë, më 12 nëntor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Saranda Bogujevci dhe Mirjeta Kalludra.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Shyqiri Bytyqi-MASHT, Leonora Morina-Bunjaku- zëvendësministre në MKRS, Lulevera Behluli-MASHT, Qëndresa Rashiti-MKRS, Ismet Osdautaj-MASHT, Arnella Hoxha-Down Syndrom Kosova, Edon Baliqi-KDI, Saranda Uka-FKAK, Bujar Kadriu, kryetar FKAK, Mexhid Foniqi-SHVK, Kushtrim Xhelili-FKAK, Bardh Prekaj-SHVK, Jasmin Maksuti-IVK, Jusuf Fazliu-IVK, Rukije Gashi-SHKSH, Selman Hoti-Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, Enver Kurtaliu-Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, Fisnik Galani-Handikos, Flora Kryeziu-UNICEF, Sebahate Beqiri-Down Syndrom, Besiana Dauti-Ekonomia Online, Mirjeta Duraku-KosovaPress, Pajtim Quni-Radio Kosova dhe Halil Kurmehaj-IVK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Raportim në Komision lidhur me zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 – 2023. Të ftuar: Skender Reqica - Ministër i Punës, Shyqiri Bytyçi - Ministër i MASHT-it, Uran Ismaili - Ministër i Shëndetësisë, Kujtim Gashi- Ministër i Kulturës

Rinisë dhe Sportit dhe Organizata Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar;

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

3. Të ndryshme.

Kryetarja tha se në këtë takim kemi ftuar ministrat kompetent dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara lidhur me zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës.

Shyqiri Bytyqi tha se bazuar në masat të cilat janë përcaktuar me planin nacional të personave me aftësi të kufizuara, MASHT ka adresuar të gjitha obligimet që dalin për Ministrin e Arsimit dhe janë marrë masa konkrete që këto masa të deleguara për ministrinë edhe të realizohen. Në kuadër të kësaj së pari janë bërë intervenimet e infrastrukturës ligjore, ku janë draftuar 3 udhëzime administrative, të cilat i prekin këto çështje të kësaj kategorie të ndjeshme që kemi në shoqërinë tonë. Udhëzimi i parë ka të bëjë me qendrat burimore cili tash është funksional dhe i zbatueshëm, pastaj Udhëzimi Administrativ për ekipin vlerësues pedagogjik i cili është shpërndarë në bashkëpunim me komunat dhe është në zbatim, si dhe Udhëzimi për hartimin dhe zbatimin e planit individual të arsimit që po ashtu është në zbatim.

MASHT ka vazhduar me zbatimin e objektivave të tjera që dalin nga kjo strategji, ku janë hartuar instrumente të standardizuara për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm dhe ka filluar si projekt pilot në 7 komuna me 14 shkolla.

MASHT në bashkëpunim me komunat dhe me dy profesorë nga Universitetet e Bolonjës dhe Padovës, kemi në zbatim e sipër një projekt tjetër në 17 komuna të cilat do të zgjasin deri në qershorin e vitit 2019. Ai tha se në grandin specifik për vitin 2019 i kemi edhe 100 asistentë të rinj për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky është një angazhim i yni i cili ka dhënë rezultat dhe tani këta 100 asistent do të jenë të punësuar në vitin 2019, ju kanë shpërndarë komunave sipas nevojave dhe sipas numrit të fëmijëve që ekzistojnë nëpër komuna.

Po ashtu janë punësuar edhe 9 mësues, mbështetës nëpër komunat të cilat kanë pasur nevojë sipas kërkesave të shkollave, dhe me këtë ka arritur në 85 numri i mësimit mbështetës në tërë nivelin e Kosovës. Gjithashtu, janë punësuar dy instruktorë të gjuhës së shenjave dhe në vitin 2019, pritet edhe punësimi i një asistenti të gjuhës së shenjave që ka për qëllim të ndihmojë procesin.

Leonora Morina- Bunjaku tha se departamentet e MKRS-së, duke zbatuar politikat programore për personat me aftësi të kufizuara gjatë periudhës 2018, kanë filluar zbatimin e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara duke ndarë buxhet dhe duke realizuar projekte në përkrahjen dhe përmirësimin e kushteve të kësaj kategorie, në kulture rini sport dhe trashëgimi.

Bujar Kadriu tha se pikat kryesore që kanë pasur për t'i adresuar nuk kanë kujt t'i adresohen pasi që mungon Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe Ministri i Shëndetësisë të cilat kanë pasur një mori veprimesh për t'i realizuar. Sa i përket Ministrisë së Kulturës, plani i veprimit nuk i parasheh subvencionet e organizatave të shoqërisë civile, parasheh diçka më konkrete. Informatat nga Ministria e Kulturës që i morëm, i kemi edhe në ueb- faqe të ministrisë. Sa i përket MASHT-it tha se u pa një progres sidomos me udhëzimin administrativ dhe hartimin e politikave të qëndrueshme. Tha se shpreson se nga ky takim do të dalin

rekomandime që në kuadër të planit të veprimit në kuadër të strategjisë, sidomos nga fusha e legjislativë të hartimit të politikave të reja, të hynë rekomandimi për koncept dokumentin e ligjit gjithëpërfshirës i cili urgjentisht duhet të aprovohet në Kuvend.

Jasmin Maksuti, sa i përket çështjes së arsimit, tha se është bërë progres sa i përket personave me aftësi të kufizuara, dhe nga këtu bëjë thirrje që personat me aftësi të kufizuara duhet të integrohen në arsimimin normal dhe theksoi se sa u përket personave të verbër ka ngecje në literaturë, sidomos të arsimimi universitar.

Sa i përket sportit dhe kulturës kërkoi të punohet me shumë për integrimin e personave me aftësi të kufizuara dhe tha se mbas këtij takimi si iniciativë do të dalin me vlerësimin se çka është punuar deri tani dhe me kërkesat se çka të bëhet për të ardhmen.

Enver Kurtalani tha se shqetësimi më i madh është se fëmijët e shurdhër të cilët e përfundojnë shkollën e mesme apo shkollën profesionale, 96% e tyre nuk dinë shkrim -lexim pra, janë analfabet, për këtë arsye në vitin 2013, kemi bërë një marrëveshje bashkë me MASHT-in për trajnimin e ekspertëve dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave në mënyrë që të përkrahet përmirësimi i cilësisë së arsimit për këtë kategori të nxënësve. Nevoja është që fëmija i shurdhër duhet të ketë mësim dhënie në gjuhën e shenjave të tij apo saj, për këtë lus deputetët të bëjnë më tepër presion për implementimin e kësaj marrëveshje drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit.

Sebahate Beqiri tha se vërehen disa përmirësime por gjendja e personave me aftësi të kufizuara ende vazhdon të jetë shumë e rëndë. Tha se nuk kërkojnë të trajtohen me lëmoshë, por të trajtohen në bazë të drejtave që ua garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe të gjitha ligjet e tjera që prekin personat me aftësi të kufizuara. Sa i përket fushës së arsimit shprehim shqetësimin me numrin e madh të asistentëve që ende i kemi në shkollat publike të cilat paguhen nga vet prindërit dhe një gjë të tillë e ndalon ligji për arsimin para universitar, numri i asistentëve përafërsisht duhet të jetë 100 dhe nga informata që i kemi ende 100 asistentë nuk janë të certifikuar dhe nuk janë të sigurt se 100 asistent do të fillojnë punën në janar të vitit 2019, ndërsa kemi një numër shumë të madh të fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë pjesë e shkollave të rregullta dhe ky numër i asistentëve nuk do të mbulojë as 10% të nevojave që i kemi në terren.

Shprehim shqetësimin tonë se jo të gjitha ekipet vlerësuese janë funksionale dhe nga informatat që i kemi në terren ekipet vlerësuese që nuk janë funksionale janë në komunat: Obiliq, Junik, Deçan, Dragash, Klinë, Suharekë, Rahovec dhe Kamenicë. Shprehim shqetësimin tonë për termet që përdoren ende në tekstet shkollore kemi kërkuar vitin e kaluar në Biologjinë e klasës së 10 dhe të 11, Sindromi Down paraqitet me një term që është i ndaluar që nga vitet e 80-ta prej OBSH-së dhe ne po ju japim mundësin fëmijëve që ende të mësohen me paragjykimet rreth komunitetit me aftësi të kufizuara, sepse këtë ne po ua mësojmë në shkolla, kemi kërkuar nga ministria që kur të vijë te kjo njësi mësimor të kalohet dhe përdoret materiali që e ka përgatitur shoqata Down syndrom Kosova, deri sa ne nuk kemi asnjë informatë se ku jemi me këtë material, gjithashtu në abetaren e klasës së parë ka terme ofenduese sa i përket aftësisë së kufizuar fizike, mendon që këto çështje duhet të trajtohen me urgjencë sepse jemi duke edukuar breza në frymën e paragjyqimeve dhe frymën e stereotipive.

Mexhid Foniqi tha se si komunitet i të verbërve janë të privuar nga e drejta e shfrytëzimit të leximit të bardhë e zi, por e përdorim shkrimin me shkronja të brailit dhe me ndihmën e

teknologjisë informative kemi arritur që të bëjmë një punë jashtëzakonisht të madhe në të drejtën e informimit. Por një shqetësim të cilin e bartim që disa vite është çështja e sintezës vokale teknike e cila e mëson personin e verbër të ketë qasje në të gjitha informatat teknologjisë informative, ku personi i verbër mund të jetë i barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë, prandaj është kërkesë e drejtpërdrejtë për Ministrin e Arsimit që në kontakt me ministrin e Arsimit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e dy qeverive, e cila do të mbahet në fund të këtij muaji, që të iniciojnë çështjen e hartimit të sintezës vokale, meqenëse është një punë e cila kushton dhe vetëm një qeveri nuk ka mundësi ta përballojë.

Rukije Gashi tha se jemi kundër sistemit të edukimit që vazhdon para 70 viteve i njëjti avaz i njëjti edukim. Tha se kërkon të punojmë të mos i humbim donatorët nga Finlanda, ata në strategji e kanë edhe hartimin e kurikulës për gjuhën e shenjave në Fakultetin e Edukimit, dhe për Ministrinë e Kulturës dhe Komunitat. Më vjen shumë keq kur thuhet se i kemi punësuar personat me aftësi të kufizuara për tri ditë.

Halil Kurmehaj tha se sa i përket çështjes së arsimit universitar ju kishim lutur që të ndihmoni, duke pasur parasysh faktin për t'i pajisur universitetet publike me dhoma të veçanta me një qendër mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara ku do të hynin të gjitha kategoritë e këtij komuniteti. Po ashtu lusim MASHT dhe deputetët që kjo qendër të jetë gjithë përfshirëse në mënyrë që Universiteti Publik i Prishtinës ta ketë këtë qendër duke përfshirë edhe pajisjet e nevojshme të përshtatshme, por duke i larguar organizatat joqeveritare ose së paku ato të jenë në rolin e monitoruesit ose respektivisht të këshillë dhënies, por jo të krijohet ndonjë monopol financiar. Më pas tha se nuk ka asnjë pengesë ligjore që librezat për këtë komunitet ti lëshon qeveria gjegjësisht Ministria e Punës dhe po ashtu përmendi edhe çështjen e Komisionit Mediko Social që është ndërruar, e që në fakt kemi pasur vetëm ndërrim anasjelltas dhe asnjë ndëshkim për ata që kanë shkelur ligjin për katër vite radhazi.

Shyqiri Bytyqi tha se të gjitha shqetësimet që u paraqiten nga shoqatat janë edhe shqetësime tona dhe kemi marrë veprime konkrete mbi bazën e strategjisë, por që akoma kemi shumë për të bërë, nuk është e mundur që të gjitha gjërat të përmbillen për një kohë të shkurtër. Tha se jemi shumë të hapur për takime me të gjithë, por nganjëherë kemi agjenda shumë të ngarkuara dhe duhet të kuptohemi. Sa i përket integritetit të rregullt është bërë një hap shumë pozitiv dhe thuhet 98% fëmijët janë përfshirë në mësimin e rregullt, ka mbetur edhe një pjesë e vogël dhe duhet bërë një analizë e saktë se a duhet të futen në integritet apo duhet qenë pjesë e veçantë. Sa i përket çështjes së teksteve kemi marrë masat të cilat kanë qenë të mundura për me u ndërmarrë dhe t'i kemi në dispozicion tekstet e reja për vitin shkollor 2019 – 2020. Ka qenë e pamundur që për një periudhë të shkurtër të ndërrohen të gjitha tekstet sepse kemi dashur që këto tekste të jenë me standarde të plota ndërkombëtare dhe ka qenë obligim i çdo autori dhe çdo shtëpie botuese që mos të përdor asnjë fjalë diskriminuese për çfarëdo kategorie. Kemi bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë, dhe kjo është një temë që mund ta hapim për sintezën që është shumë me rëndësi dhe besoj se mund ta gjejmë një gjuhë të përbashkët në këtë drejtim.

Lulavera Behluli tha se Qendra burimore është e vetmja në Kosovë që furnizon nxënësit që nga klasa e parë deri në klasën e 12 me tekste, qoftë me tekste të zmadhuara në bazë të llojit të aftësisë se kufizuar në bazë të shikimit që nxënësit kanë nevojë. Sa i përket nxënësve të shurdhër me këtë problematik nuk ballafaqohet vetëm Kosova por edhe rajoni, gjuha e shenjave në Kosovë deri në vitin 2010 nuk ka qenë fare e standardizuar dhe nga viti 2010 kemi

një gjuhë e cila mund të promovohet dhe mund të jetë pjesë e sistemit të arsimit. Nga viti 2016 në bashkëpunim me shoqatën dhe finlandezet kemi punësuar një instruktorë të gjuhës së shenjave i cili afron gjuhën e shenjave në qendrën Burimore Nënë Tereza në Prizren, e cila është e vetmja në Kosovë, mirëpo nuk mundem të presim nga stafi që për një vit ta mësojnë gjuhën e shenjave dhe nuk mund të presim kualitetet përderisa mësimdhënësit nuk e njohin gjuhën e shenjave të nivelit çfarë duhet ta njohin.

Teuta Haxhiu bëri pyetje se sa janë të gjitha kërkesat për asistentë në fazën fillestare. Nuk do të ndalemi duke kërkuar që të gjejmë zgjidhje për ju dhe të ju ndihmojmë familjeve. Shqetësimi është se nuk kemi mësues për me i mësuar këta nxënës, e për me bërë një mësues sa kohë dhe sa investim na duhet, këtë problem e kam ngritur edhe kur ishim në takim me një komision të përbashkët me përfaqësues nga Shqipëria, dhe ky problem ishte evident edhe atje. Është mirë t'i përmbledheni kërkesat e juaja për secilën ministri që i keni dhe t' na i adresoni sepse me këtë do të na ndihmonit sepse bashkë mund të arrimë gjithçka, por vetëm nëse lëmë një adresë të saktë.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se nga monitorimi i ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në komponentin e mirëqenies sociale me të diskriminuarit janë personat me aftësi të kufizuara. Në MPMS thuhet se për komunitetin e të shurdhërve është bërë progres me zyrtarizmin e gjuhës së shenjave dhe secilit qytetar që është i shurdhër e që ka nevojë i sigurohet një interpretim në gjuhën e shenjave dhe kjo është një e arritur sepse çdo gjë kemi filluar nga zero dhe kemi qenë si shoqëri në tranzicion. Sa i përket arsimit gjithë përfshirës është punuar shumë nga MASHT, me vite të tëra, mbetet shqetësuese çështja e teksteve të kemi kujdes dhe të hartojmë tekste adekuate për secilën klasë, e në veçanti për studimet universitare.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se duhet të dimë sa mësimdhënës janë trajnuar për arsimin gjithë përfshirës, trajnimi a ka qenë adekuat dhe të bëhet një vlerësim profesional për mësim dhënësit. Tha se brengën e ka se si do të bëhet kategorizimi për parashkollorët, për nivelin e ulët, a janë të ndara asistenti, edukatori mbështetës, mësimdhënësi udhëtues. Si ministri mund ta merrni obligim që me një udhëzim të eliminohet ajo faqe që u cek se është problem te libri i klasës së 10 dhe te abetarja. Ajo po ashtu tha se kemi një hulumtim të bërë nga forumi kosovar për aftësi të kufizuara dhe kemi rekomandimet që i kanë nxjerrë, është e rrugës që për secilin rekomandim të na sjellin përgjigjeje MASHT, MKRS, por edhe MPMS, që të dimë a të parashtrijmë pyetje parlamentare, a të bëjmë kërkesa individuale për buxhet apo çka mundemi të ndikojmë ne si deputetë.

Fisnik Ismaili: Nga ajo se çka tha zonja Sebahate u përfshinë të gjitha dhe se projektligji gjithëpërfshirës duhet t'i përfshijë dhe t'i zgjidhë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë grup të neglizhuar të njerëzve në sheqerin tonë. Janë çështje që duhet t'i ngrehim çdoherë me pyetje parlamentare në Kuvend dhe duhet bërë presion në qeveri për të ndërmarrë masa.

Shemsi Sylja tha se të gjitha këto çka u thanë sot këtu dhe çështjet që u zotuan janë një obligim për neve në të ardhmen, që si Komision t'i dalim ballë kësaj detyre që e konsideroj shumë të rëndësishme.

Lirije Kajtazi tha se nuk është mirë mos përgjigjja e ministrave ndaj ftesës së komisionit. Së paku ka mundur të delegohet ndonjë zëvendësministër, sepse agjendat e Komisionit Funkcional janë me prioritet. Duke u ndërlidhur me temën tha se te fondet që jepen për OJQ kemi pasur

mjaft vërejtje dhe u pa edhe këtu se fonde ka, por problemi më i madh qëndron se a e arrin ato qëllimin, për të gjitha këto mbetet shumë punë për t'u bërë.

Shyqiri Bytyqi tha se problemet janë të grumbulluara shumë vite dhe nuk mund të zgjidhen lehtë përtej vullnetit, na duhet kohë për t'i zgjidhur. Sa u përket teksteve që nga viti i kaluar kur ka ardhur shqetësimi nga shoqata kemi marrë masa të menjëhershme dhe vitin e kaluar këtë material e kemi shpërndarë në të gjitha shkollat dhe nëse nuk ka shkuar në çdo shkollë duhet të kërkojmë nga komunat se çka ka ndodhur me këtë material që e ka pasur obligim me shpërndarë.

Kryetarja falënderoi të gjithë për prezencën dhe tha se sërish do të jemi bashkë për të punuar në zgjidhjen e problemeve.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetarja konstatoi se procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 4 korrik, 20 korrik dhe 17 shtator 2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Të ndryshme

Kryetarja tha se të hënën, më 19 nëntor, jeni të ftuar për të marrë pjesë në dëgjimin publik për shënimin e Konventës për të drejtat e fëmijëve.

Teuta Haxhiu tha se ka një kërkesë që të mërkurën më 14 nëntor të ftohen në mbledhje për rastin në kompleksin memorial në Meje, drejtori i Agjencisë për Mbrojtjen e Komplekseve memorial, përfaqësuesit e Shoqatës, si dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, pasi që është një problem lidhur me fotografitë, kompania kontraktuese nuk po pranon me ua kthyer familjareve fotografitë që i ka marrë për me i punuar dhe kjo është një shkelje e rëndë që po u bëhet. Gjithashtu të kërkohet informacion nga Prokuroria se a është bërë diçka në hetimin këtij rasti.

Kryetarja konstatoi se komisioni do të mbajë mbledhje, të mërkurën më 14 nëntor 2019, në orën 10.

Lirije Kajtazi i njoftoi anëtarët e komisioni se një autobus me mërgimtarë duke shkuar për Austri është sulmuar në Serbi.

Shemsi Sylja tha se çështja e vizitave të anëtarëve të komisionit jashtë vendit është mirë të diskutohet dhe të merret vendim në komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje

